



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 1450 Prot

Vlorë, më 24 .09 .2024

VENDIM

Nr. 18 Datë 23 /09 /2024

**"PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE SHITESËS PËR POZICION TË PAGËS TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR DHE EMËRUAR, TË PUNONJËSVE CIVILË DHE ADMINISTRATIVË TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË"**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur në datën e sipërpërmendur, në zbatim të Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 77; Ligjit nr. 97/2023, datë 07.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024, neni 15; Vendim i KM nr.474 dt.16/06/2011 "Për përcaktimin e standarteve dhe te procedures që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike"; Vendim i KM nr.142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura; Vendim i KM nr.325, dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nën prefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar me Vendim i KM nr. 421 datë 26.06.2024; Vendim i KM nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm"; Vendimin nr. 503 datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore; VKQ nr. 12 datë 22.06.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së KQ Vlorë", i ndryshuar neni I dhe 11,

**VENDOSI:**

1) Të miratojë strukturën organike, klasën dhe ndryshimin në nivelin e pagave, të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë sipas LIDHJES Nr.1.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

STRUKTURA

Lidhja 1

Nr	Pozicioni	Nr. Punonjësve	Kategoria	Funksioni		
<b>I KRYETARI, ZV.KRYETARI, SEKRETARI DHE KABINETI I KËSHILLIT TË QARKUT</b>						
	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatar	260.000
	Zv. Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatar	180.000
	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	një	I-5	I emëruar	120,000
1	Zdh. Kryetarit dhe këshilltar/e për marrëdhëniet me median dhe publikun.	1	një	II-2	Mbështetës	85,000
2	Këshilltar për Qeverisjen Vendore, Inovacionin dhe zbatimin e Projekteve	1	një	II-2	Mbështetës	85,000
<b>II DREJTORIA E FINANCES, ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE SOCIAL</b>						
3	Drejtor Drejtorie - Financë	1	një	II-2	Nënpunës Civil	140,000
<b>II-1 Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Koordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit</b>						
4	Specialist Finance për zbatimin e buxhetit	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
5	Specialist për Arsimin, kulturën, turizmin, çështjet sociale dhe zhvillimin e Projekteve.	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
6	Specialist për Shërbimet, Transportin dhe emergjencat civile	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
7	Specialist për zbatimin e Projekteve	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
<b>II-2 Sektori i Ligjshmërisë, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit</b>						
8	Specialist i Protokoll - Arkivës dhe Burimeve Njerëzore	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
9	Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e territorit	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000
10	Specialist jurist	1	një	IV-2	Nënpunës Civil	80,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

IV DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS						
11	Drejtor i DAMT	1	një	III -1	Nëpunës Civil	115,000
Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës						
12	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000
13	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000
14	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000
15	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000
16	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000
17	Specialist Delvinë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	70,000

2) Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10) vite dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11-20) vite dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1 % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21-30) vite dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

3) Fondi i pagës për këtë rritje do të pasqyrohet në Buxhetin e Këshillit të Qarkut të vitit 2024.

4) Ffektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 01 Korrik 2024 për nëpunësit e DAMT dhe nga data 01 Shtator 2024 për funksionarët e zgjedhur dhe emëruar dhe punonjësit e tjerë të administratës së Këshillit të Qarkut, dhe do të përballohen nga fondit i pagave dhe sigurimeve (600 - 601).

5) Ndryshimet e Strukturës të reflektohen në Rrregulloren e funksionimit të Administratës.

6) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

7) Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit 139/2015, date 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 877/11 Prot, datë 25.09.2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site: [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 21, DATË 28.12.2022 TË  
KËSHILLIT TË QARKUT VLORË 'PËR STRUKTURËN ORGANIKE TË  
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË, PËR VITIN 2023',  
VLORË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në kushtet e ndryshimeve të kuadrit ligjor në fuqi i cili përcakton nivelin dhe kufijtë minimal dhe maksimal të pagave, përkatësisht Vendimit nr. 503 datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023, Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore" si dhe VKM nr.325, dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nën prefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike"; Vendimin e KM nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", i cili në Nenin 30 përcakton se Struktura organizative e institucioneve të administratës shtetërore ndryshohet në rastet kur: a) ka ndryshime të misionit të institucionit; b) janë shtuar apo pakësuar funksionet e institucionit; c) si rrjedhojë e analizave vjetore të kryera, rezulton së duhet të ketë një shpërndarje të ndryshme të burimeve të shtuara për kryerjen e funksioneve; Rregullores se Këshillit të Qarkut Vlorë miratuar me VKQ nr.12 datë 22.06.2020, e ndryshuar, nenet 1 dhe 11;

Të nderuar Këshilltarë,

Me Vendimin nr. 503 datë 01.08.2024, Këshill i Ministrave ka ndryshuar Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore", duke miratuar klasifikim e ri të funksioneve dhe kufijtë e nivelit të pagave. Duke nisur nga ky fakt dhe duke marrë parasysh ngarkesën e punës së çdo pozicioni dhe mos krijimin e disniveleve në trajtimin financiar të punonjësve të administratës, paraqesim për miratim ndryshimet sipas Lidhjes nr.1.

Gjithashtu nisur nga relacionet vjetore të sektorëve në të cilët rezultoj se disa emërtime të funksioneve të specialistëve nuk përputhen më me funksionet aktuale, pasi shumë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**

funksiione prej kohësh u janë transferuar Bashkive, si dhe referuar legjisllacionit në fuqi dhe më konkretisht VKM Nr. 142, datë 12.3.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar; si dhe pas miratimit të "Planit Strategjik të vlerësimit të nevojave të territorit për zhvillimin ekonomik" me Vendim nr. 08 datë 26.03.2024 të KQ, lind nevoja e rishikimit të pozicioneve dhe përshkrimeve të qarta të punës në bazë të rolit të politikave rajonale dhe koordinuese të institucionit të KQ.

Në këtë mënyrë është vënë re se në institucion të vogël si KQ nuk është i nevojshëm pozicioni i nivelit të lartë drejtues për shkak të mungesës së drejtorive të përgjithshme apo komplekse për të cilat nevojitet një nivel i lartë koordinimi dhe për më tepër kur mungon dhe vet drejtoria si nivel i dytë më i ulët në strukturën organizative (neni 13 i Ligjit Nr. 90/2012, datë 27.9.2012). Pavarësisht se me VKQ u parashikua një pozicion i nivelit të lartë drejtues, nga praktika vihet re se nuk ka sjellë rezultatet e pritshme. Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në nenin 83/d parashikon shprehimisht si kompetencë të Kryetarit të KQ "drejtimin e administratës së këshillit të qarkut dhe përgjigjet para këshillit për funksionimin e saj".

Po kështu në bazë të Ligjit Nr. 90/2012, datë 27.9.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficientës dhe efektivitetit, 2. Sipas parimit të unitetit dhe hierarkisë, administrata shtetërore organizohet në mënyrë të atillë që çdo organ, institucion apo njësi administrative, është në varësinë dhe i raporton vetëm një organi, institucioni apo njësi administrative, eprorë. 3. Sipas parimit të llogaridhënies, çdo organ, institucion apo njësi administrative i nënshtrohet drejtimin dhe mbikëqyrjes nga organi eprorë përkatës,....". Në bazë të Ligjit 139/2015 organi eprorë i vetëm është Kryetari i Qarkut i cili drejton administratën dhe përgjigjet para Këshillit.

Një tjetër arsye për të cilin sot paraqesim para Këshillit rishikimin e strukturës së KQ është dhe parashikimi i Nenit 16 të Ligjit Nr. 90/2012, datë 27.9.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", i cili përcakton se:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet juridike, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, në vijim "shërbimet e brendshme mbështetëse", gjë e cila me strukturën aktuale nuk rezulton;
2. Funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar, më poshtë "funksionet e financave", kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

4. Njësitë e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni organizohen në sektorë, drejtori apo drejtori të përgjithshme, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të detyrave përkatëse. Pra vihet re se struktura aktuale nuk përshtate me kërkesat e mësipërme, për këtë qëllim rishikohet dhe strukturimi në sektorë apo drejtori që përmbushin këtë parashikim ligjor. Gjithashtu theksojmë se ndryshimi i strukturës nuk prek shkurtime në personel apo lirime nga puna, pasi nëpunësve aktuale do tu ofrohet vendi i punës i krijuar.

Nga sa më sipër dhe konform Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", i cili parashikon se: 17. *Institucionet e administratës shtetërore përbëhen nga njësi organizative të cilat krijohen në bazë të identifikimit të kompetencave kryesore. Pozicionet, që kryejnë funksione të së njëjtës fushë, grupohen në sektorë, drejtori dhe drejtori të përgjithshme, në rast së plotësohet standardi numerik për krijimin e njësisë organizative respektive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe 22. Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës. 23. Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës; bazuar në analizën vjetore, qëllimin e ndryshuar institucional drejtuar tashmë drejt koordinimit mbi zhvillimin e turizmit, agroturizmit dhe përthithjes së fondeve me financim të huaj si dhe në përshkrimet e punës të përgatitura nga Përgjegjësiti e sektorëve, bazuar në VKQ nr. 12 datë 22.06.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së KQ Vlorë", i ndryshuar neni 1 dhe 11, propozojmë ndryshimet sipas Lidhjes nr. 1.*

Për Sektorin e Burimeve Njerëzore Përgjegjës:

Alma Myrtaj *Alma*

Për Sektorin e Financës Përgjegjës:

Anisa Hyseni *Anisa*

Për DAMT - Drejtor:

Benard Koço

